

Abstrakti

Qëllimi kryesor i shteteve në zhvillim është mundësia për t'u integruar në tregun ekonomik me shtetet e tjera të zhvilluara nga të cilat mund të përfitojnë investime, zhvillim, rritje kapitale, biznese, njohje ndërkombëtare, reduktimi i rrezikut për investime në biznese të vogla e të mëdha. Sistemi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar të gjitha këto qëllime i ka bërë më lehtë të arritura nga aplikimi i standardeve të raportimit të financave. Si avantazh që Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ofrojnë është: Krahasueshmëri më e madhe sepse kompanitë e mëdha që përdorin të njëjtat standarde për të përgatitur pasqyrat e tyre financiare

mund të krahasohen me njëra-tjetrën më saktë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur krahasohen kompanitë e vendosura në vende të ndryshme, pasi përndryshe ato mund të përdorin

rregulla dhe metodologji të ndryshme për të përgatitur deklaratat e tyre. Kjo rritje e krahasueshmërisë i ka ndihmuar investitorët të përcaktojnë më mirë se ku duhet të shkojnë dollarët e tyre të investimeve. Më shumë fleksibilitet sepse SNRF përdor një filozofi të bazuar në

parime dhe jo në rregulla. Një filozofi e bazuar në parime do të thotë që qëllimi i çdo standardi është të arrihet në një vlerësim të arsyeshëm dhe se ka shumë mënyra për të arritur atje. Kjo u jep

kompanive lirinë për të përshtatur SNRF me situatën e tyre të veçantë, gjë që dërgon në deklarata

më të lehta për t'u lexuar dhe më të dobishme.

Ky punim ka për qëllim të pasqyroj rëndësinë e adoptimit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar në vendet në zhvillim. Nëse e zhvillojnë atë vend këto avantazhe të standardeve, a lidhen juridiksionet më shumë me ndihmën e këtyre standardeve, a zhvillohen bizneset, a fitohet besueshmëria nga vendet e tjera të zhvilluara, a reduktohet rreziku i marrveshjeve biznese.

Kandidat: Genc Vitaku

Mentor: Prof.Ass.Dr.Artor Nuhiu